



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

**N J O F T I M**

Shërbimi Informativ i Shtetit kërkon të punësojë shtetas, të cilët pas konkurrimit do t'i nënshtrohen dhe një trajnimit.

Nevojat e SHISH janë fokusuar në:

- Inspektorë në SHISH, të gatshëm për të punuar në terren dhe jashtë vendbanimit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e poshtëshënuara:**

- Të jenë shtetas shqiptar;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të kenë mbaruar arsimin e lartë;
- Të mos jenë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një krimi;
- Të jenë të aftë nga ana shëndetësore, për të kryer detyrën;
- Të mos jetë marrë ndaj tyre masë disiplinore e largimit nga administrata shtetërore për shkak të një shkelje të rëndë të disiplinës.

**Preferohen:**

- Të kenë njohuri të mira në gjuhën angleze, apo gjuhë të tjera;
- Të jenë deri në moshën 35-vjeç;
- Të kenë njohuri për programet bazë të kompjuterit;

**Të interesuarit të paraqiten pranë Njësive të SHISH në rrethet pranë vendbanimeve, si dhe pranë Shërbimit Informativ të Shtetit në AQ, Tiranë, deri në datën 31/12/2021, me dokumentet e mëposhtme:**

- Kërkesë për punësim;
- CV, sipas modelit bashkëlidhur, të publikuar dhe në faqen zyrtare të SHISH;
- Fotokopje e kartës së identitetit, apo pasaportës;
- Certifikatë familjare;
- Raport mjeko-ligjor ;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së arsimit përkatës dhe e listës së notave;
- Vërtetim nga Prokuroria e rrethit përkatës;
- Vërtetim nga Gjykata e rrethit përkatës;
- Vërtetim nga Zyra Përmbartimore e rrethit përkatës;
- Vërtetim nga administrata shtetërore (në rastet kur kanë qenë të punësuar), që nuk janë larguar nga puna me masë disiplinore, për shkak të një shkelje të rëndë të disiplinës;
- Certifikata apo dëshmi për njohuri në gjuhët e huaja, kompjuter, si dhe certifikatë trajnimesh në sfera të tjera, (nëse kanë).
- Fotografi 4x6 (4 copë) dhe 9x12 (2 copë).

**Dokumente të tjera plotësuese, nëse disponojnë:**

- a) Vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm;
- b) Fotokopje të librezës së punës.

**D R E J T O R I**

**Helidon Bendo**